

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Albana Shtylla kryesuese, Natasha Mulaj relatore, Mimoza Tasi, Rezarta Schuetz, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 9/2022, datë 15.02.2022, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 491, datë 21.12.2021, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra.

Në përfundim të gjyqimit, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 491, datë 21.12.2021 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.07.2022.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/)), NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME-SQ/](https://kpa.al/category/njoftime-sq/))